




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL III/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së III (tretë) për vitin 2025 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 20.03.2025
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-51839,të datës 30.08.2024;**

Kryesuesi-Ju informoj se kemi pranuar një shkresë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) lidhur me vendimin e miratuar më 28.02.2025, për dhënien në shfrytëzim të hapësirave për pano reklamuese. Sipas kësaj shkrese, është konstatuar se vendimi në fjalë nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Për këtë arsye, kërkohet që projekt-vendimi për shfuqizimin e tij të procedohet për shqyrtim në Asamblenë Komunale.

Urim Suka-Nëse është e mundur, a mund të na sqarojë dikush arsyet për këtë situatë?

Kryesuesi-Arsyetimi i dhënë në këtë rast është i qartë dhe i dokumentuar. Kjo çështje është rregulluar me Rregulloren nr. 016-20161, e cila përcakton procedurat për dhënien në shfrytëzim për më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës. Kjo rregullore është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës më 30.03.2021. Në bazë të nenit 5, paragrafit 2, pika 2.1 të kësaj rregulloreje, përcaktohet qartë se prona e paluajtshme e komunës që mund të jepet në shfrytëzim përfshin hapësirat publike, si: parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese dhe objekte të ngjashme. Pra, këtë çështje e kemi të përcaktuar qartë në rregulloren e miratuar nga ne.

Avni Bytyqi-Përshëndetje të pranishmëve. Çështja e panove reklamuese ka qenë e rregulluar me vendim të Asamblesë që nga viti 2012. Ky vendim ishte bazuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme, i cili ishte miratuar në vitin 2012. Ky ligj ka pësuar ndryshime tri herë deri më sot, përkatësisht i fundit është në vitet 2019. Në atë kohë, ishte menduar se Kuvendi ka kompetencë për të dhënë në shfrytëzim pronën komunale, dhe ne kemi dhënë këtë shfrytëzim për periudha afatshkurtra prej 10 vjetësh dhe afatgjata prej 45 vjetësh. Më vonë, rreth viteve 2014-2015, ligji ndryshoi, duke e përcaktuar afatin e shfrytëzimit në 15 dhe 99 vjet. Në periudhën kur u mor vendimi në vitin 2012, ishte parashikuar që për shfrytëzimin afatshkurtër deri në 10 vjet kërkohet konfirmimi i Ministrisë. Siç dihet, deri në vitin 2022 ka pasur kontratë për këtë çështje, ndërsa nga viti 2022 e deri më sot, ajo nuk ka qenë e rregulluar me kontratë. Në këtë drejtim, ka ardhur një kërkesë nga Drejtoria e Pronës, të cilën unë, së bashku me Kryesuesin, Drejtorin e Pronës, Drejtorin e Urbanizmit dhe Kryetarin, e kemi diskutuar në zyrën e Kryetarit. Gjatë këtij diskutimi, i kam njoftuar për procedurat dhe kam dhënë sqarimin tim ligjor dhe mendimin tim profesional. Megjithatë, dua të theksoj se mendimet dhe opinionet e mia ligjore nuk janë obligative as për Kryetarin, as për Kryesuesin, as për drejtorët dhe as për Asamblenë. Ju jeni ata që merrni vendimet. Sqarimi që kam dhënë në zyrën e Kryetarit është i njëjtë me atë që ka dhënë edhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), e cila ka konfirmuar se kjo çështje është e

rregulluar me rregullore për dhënien në shfrytëzim për më pak se 1 vit. Megjithatë, kërkesa e tyre ishte që kjo çështje të procedohej më tej. Unë e kam përcjellë atë dhe është shqyrtuar. Ju keni marrë vendimin tuaj, dhe Ministria e ka kthyer vendimin duke përcaktuar se dhënia në shfrytëzim e panove reklamuese nga Komuna mund të bëhet vetëm në bazë të rregullores së miratuar nga Kuvendi në vitin 2021. Unë kam qenë kryesues i grupit të punës për hartimin e kësaj rregulloreje, dhe ajo ka marrë konfirmimin ligjor nga Ministria!

Kryesuesi –ne e kemi obligim me zbatu çdo shkresë qe vjen nga niveli qendror dhe e kemi obligim me e dergu ne Asamble,dhe e hedh ne votim piken shtesë.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi-kemi një pikë shtesë qësa po u soll nga Drejtori i Pronës.Nga sa po e shoh,bëhet fjalë për një pronë komunale.Meqë nuk kemi pasur mundësinë të lexojmë materialin paraprakisht dhe nuk jemi te informuar plotësisht mbi përmbajtjen e tij,kërkoj nga Drejtori që të na sqarohet më hollësisht.

Armend Krasniqi-Të nderuar të pranishëm, kemi pranuar një kërkesë për këmbim prone komunale me atë të një personi fizik, për shkak të ndërtimit apo rregullimit të një parcele për ndërtim sipas DPSh-së. Komuna në këtë zonë i merr 149 m², ndërsa jep 84 m². Bëhet fjalë saktësisht për një këmbim ku kemi 55 m² me 55 m² ku edhe më parë është diskutuar dhe është theksuar se duhet të rregullohet pjesa tjetër.Tani ka ardhur dhe një vendim tjetër që ndihmon në zgjidhjen e problemit që kanë pasur pronarët dhe duam ta çojmë më tutje si option, pasi Komuna fiton 50-60 m² më shumë. Këta janë të interesuar për marrëveshje dhe për ne si komunë kjo është një mundësi e mirë. Nëse miratohet, kjo do të jetë si kërkesë. Nëse keni ndonjë pyetje, urdhëroni.

Avni Bytyqi-A është kjo kërkesë për shpalljen e interesit te përgjithshëm,apo kërkesë për këmbim?

Armend Krasniqi- është kërkesë për shpalljen e interesit të përgjithshëm,që i drejtohet Zyrës së Kryetarit.

Bulëza Kuçi- Cili është qëllimi dhe sa është urgjente kjo çështje që pa dokumenta ne me dhënë pëlqim?

Armend Krasniqi- qëllimi i kësaj është përfitimi ekonomik i Komunës dhe rregullimi i planit të cilin e ka parapa vetë Komuna.

Saniqe Kuçi Rexhepaj-Përshëndetje të pranishmëve. Rruga në fjalë është “Luigj Nikolla”. Ju lutem, na e sqaroni saktësisht lokacionin përpara se të vazhdojmë me diskutimin, pasi pa këtë informacion nuk mund të kuptojmë për çfarë bëhet fjalë.Gjithashtu, dua të rikujtoj se kjo çështje është diskutuar edhe më parë në asamble, për një kërkesë tjetër brenda të njëjtit bllok ndërtimor. Problemi lidhet me një trekëndësh prone, një pjesë e së cilës është pronë e ministrisë, pjesa tjetër është pjesë e rrugës së Brigadës 123. Kam kërkuar sqarime nga drejtoria se çfarë veprimesh janë ndërmarrë, me qëllim që të zgjidhet përfundimisht kjo çështje e cila po vazhdon të mbetet problematike.

Armend Krasniqi -Me këtë këmbim që e bën Komuna ,zgjidhet problemi sepse krijohen alternativa të reja.

Saniqe Kuçi Rexhepaj-Trekëndëshi në fjalë përfshin një rrugë që prek bllokun ndërtimor, përfshirë edhe rrugën “Brigada 123” që kalon brenda këtij blloku. Nuk e dimë saktë sa m² ka kjo zonë, por pyetja është: A mundet ligjërisht Drejtoria, në lejen ndërtimore, të sigurojë që të mos dëmtohet rruga “Brigada 123” dhe njëkohësisht t’i lejohet ndërtimi inverstitorit.

E kam bërë këtë pyetje edhe më parë, por përgjigja që kam marrë nga drejtori ka qenë që kjo çështje të trajtohet nga Drejtoria ime mirë dhe pastaj ata “të veprojnë si të duan”, gjë që për mua më është dukur qasje arrogante.Kjo është një çështje pronësore që i takon Drejtorisë së Pronës për ta zgjidhur dhe jo drejtorive tjera, ndërsa në Drejtorin e Urbanizmit duhet të sigurojë një bllok ndërtimor të pastër dhe pa probleme pronësore.

Armend Krasniqi-Kërkesa që i është paraqitur Drejtorisë sonë për këmbimin e pronës komunale me pronë individuale është trajtuar në mënyrën më të mirë të mundshme, duke marrë parasysh interesin e Komunës. Komuna përfiton jashtëzakonisht shumë nga ky këmbim, për shkak se kemi marrë shumë iniciativa të tilla dhe i kemi përcjellë në KPF çdo interes që është në favor të Komunës.Ekzekutivi ka përgatitur materialin për të filluar procedurën për leje ndërtimore dhe kjo çështje është diskutuar me

Drejtorinë e Urbanizmit. Nëse jeni të gatshëm për hapjen e rrugës sipas hartës zonale, atëherë mund të vazhdojmë me procedurat për dhënien e lejes. Në këtë rast, Komuna përfiton shumë dhe kemi një alternativë konkrete për ta zgjidhur këtë problem. Ne e kemi përgatitur gjithçka që na takon, por për dhënien ose mosdhënien e lejes (20m apo 30m), kjo është përgjegjësi e plotë e një drejtorie tjetër.

Sanije Kuçi Rexhepaj-Drejtor, dëshiroj të shtoj edhe diçka. Kam qenë pjesë e ekipit hartues të hartave zonale dhe më duket e pakuptimtë që të interpretohet sikur jam kundër zbatimit të tyre. Përkundrazi, unë gjithmonë kam qenë dhe mbetem përkrahëse e zbatimit të plotë të hartave zonale dhe hapjes së rrugëve të reja, ashtu siç janë planifikuar, me të gjitha përfitimet dhe potencialin që ato sjellin.

Urim Suka-Ajo që unë po propozoj është që, nëse po kërkohet që kjo çështje të futet në rend dite, atëherë le të futet si pikë e rendit të ditës. Drejtori le të përgatisë materialin përkatës dhe të na e shpërndajë paraprakisht në mënyrë që, kur të vijë momenti i diskutimit, të jemi të informuar dhe të bindur që po trajtojmë një çështje me interes për Komunën. Nuk ka arsye të shtyhet as për këtë muaj e as për muajin tjetër, nëse jemi të përgatitur. Do ta lutesha drejtorin që në të ardhmen të angazhohet që materialet të jenë të gatshme me kohë – nëse nuk janë gati, atëherë më mirë të mos paraqiten fare për diskutim.

Kryesuesi-e hedhë në votim si pikë shtesë

5për,1kundër,1abstenim miratohet.

Kryesuesi-Kemi edhe një kërkesë të adresuar nga asambleistja Bulëza Kuçi, të cilën do ta propozoja si pikë shtesë të rendit të ditës, për diskutim në momentin e përshtatshëm. Kjo çështje është diskutuar disa herë më parë dhe lidhet me dhënien në shfrytëzim të një lokali brenda objektit të shkollës “Destan Bajraktari”

Bulëza Kuçi-Afërsisht katër deri në pesë kërkesa janë dërguar nga shkolla në drejtim të Drejtorisë së Arsimit, pa marrë asnjëherë përgjigje konkrete apo ndonjë udhëzim se si duhet vepruar. Këshilli i Shkollës nuk ka marrë asnjë vendim të qartë, edhe pse kjo çështje i përket kompetencave të tij. Nga ajo që kemi kuptuar, Komuna nuk ka ndonjë kod buxhetor përmes të cilit personi që do të menaxhonte byfenë mund të paguaj mjetet e nevojshme. Kjo çështje është diskutuar më parë edhe në Asamble me nënkryetaren, por askush nuk ka ofruar një udhëzim të saktë me shkrim për mënyrën e veprimit. Qëllimi ynë është të arrijmë një zgjidhje konkrete, jo të zvarrisim procesin me diskutime të kota. Për shkak të kërkesave të shumta nga prindërit dhe rrezikshmërisë që po paraqitet nga hapja e tendave e lokaleve të ndryshme në ambientet e shtëpive afër shkollës, kemi vendosur që byfeja të funksionojë brenda objektit të shkollës, në një hapësirë ekzistuese dhe të përshtatshme për këtë qëllim. Për këtë arsye, e kam sjellë këtë çështje këtu për diskutim, me shpresën që të më udhëzoni për rrugën që duhet ndjekur për ta përmbyllur këtë proces.

Kryesuesi-Po flas nga përvoja ime personale si anëtar i Këshillit të Shkollës në shkollën “7 Mars”. Ne si këshill kemi marrë vendimin për hapjen e byfesë, pasi që kjo është kompetencë ekskluzive e Këshillit të Shkollës dhe jo e Asamblesë Komunale.

Avni Bytyqi-Dhënia në shfrytëzim e hapësirave –byfes brenda objektit të shkollës është kompetencë e Këshillit Drejtues të Shkollës. Këshilli merr vendimin përkatës, fton drejtorin e shkollës dhe shpall thirrjen publike – qoftë për 10 apo 15 ditë, varësisht nga vendimi. Sa i përket të hyrave, xhirollogari për të hyrat vetanake ekziston vetëm në Komunë. Të gjitha mjetet financiare derdhen në xhirollogarinë e Komunës, e cila më pas i dedikon ato për nevojat e shkollës përkatëse..

Kryesuesi-e hedh në votim rendin e ditës me dy pika shtesë

5për,0kundër,2abstenim miratohet.

Pika 1:Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi-laboron pikën e 1

Kryesuesi-e hedh në votim pikën e 1

Unanimisht miratohet

Pika 2:Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin

Sanije Kuçi Rexhepaj-nëse ka mundësi me u kompletu kjo edhe me një skicë nga harta zonale,sepse është skica e Gjeodetit me pjesë por nuk e kam të qartë si është harta zonale në atë pjesë.Nëse ka mundësi Drejtori në Asamble me na sjellë.

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 2

Unanimisht miratohet

Pika 3:Shqyrtimi i projekt-vendimit për zbatimin e prcoedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin

Urim Suka-Është detyr e jona dmth mbasë këtyre vendimeve të formohet Komisioni dhe ne mendojmë që duhet me shku.

Sanije Kuçi Rexhepaj-Normalishtë veq e kemi obligim me formu Komisioni për këto dy parcela që vetë e kemi dhën vendimin për me u dhën në shfytëzim,mirpo nëse mundët mu pltoësu vendimi këtu te parcela 003-21 dhe kjo tjetra me shënu që është zon kadastrale Samadrexhë po mungon specifikimi i zonës kadastrale.

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 3

Unanimisht miratohet

Pika 4:Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës:

Kryesuesi:laboron pikën dhe hap debatin

Kryesuesi-pasi nuk ka debat e hedhë në votin pikën 4

Unanimisht miratohet

Pika 5: Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hap debatin

Bulëza Kuçi-për më shumë detaje nëse kishë pas mundësi dikush me më tregu a. Bëhet fjalë për parcelen mbrapa Handikosit,tash duke i pasur parasyshë kërkesat e Handikosit që disa herë ata kanë pasë kërkesë për një pjesë ose një parcel për shfrytëzim të depos që ju duhet ,na po japim diqka të Komunës ku disa kërkesa të tyre i kemi pas për me ja huaza një depo për mjetet që ju duhen,që dmth shumë afer e paskan parcelen që paskan mundësi me shfrytëzu,për këtë arsyeë kërkesa ime është me shqyrtu edhe nje herë a është me e mir apo e udhës me ja dhën handikosit sepse ata po shkojnë me qera napërr parcela të huaja,apo me ja dhan një pjesës ku ndertohet banesa,

Armend Krasniqi-Këtu nëse Komuna jep 255 m² i merr 252 m² banes apo lokale sepse hyn konsensium me operatorin ekonomik për ndërtimin e lartë.Nëse Komuna i merr 250 m² atëher mundet 100 m² me ja dhën Handikosit një lokal dhe pjesën tjetër me shfrytëzu për familje të dëshmorve.Dhe nëse ajo zonë është e planifikume për ZP 5 dhe nëse Handikosi merrë dhe planifikon me ndërtu nj garazhdë që nuk përputhet me hartën zonale atëherë nuk mund të merë leje ndërtimi.

Sanije Kuçi Rexhepaj-atë qka deshta me thën e tha në fund Drejtori,kjo zonë është në kuadër të zonës së banimitm ZP 5 dhe kapaciteti i ulët veq përdhesë nuk lejohet mu ndërtu,në këtë rast Komuna mundet me

përfitu lokale qoftë për Handikosin qoftë për interesa të tjera,dhe objektet e banimit e kanë obligative me i pasë të gjitha kyqjet për persona me aftësi të kufizuar,mendojë që në të ardhmën mundet me qenë një formë e mirë për me ia plotësu kërkesat e Handikosit.

Urim Suka-Unë jam keqë me Hartat Zonale dhe nuk i kuptojë,e meta ime është kur jan miratu këto harta zonale unë nuk jam marrë shumë tu mos kanë ekspertë i kësaj fushe,dhe gjat rrugës e shohë sa shumë probleme kanë hartat zonale në vetvete.Dhe kam parë që këto kan ndodhë për qellime të caktume dhe u parapa kush qka me ndërto.Kur jem të vendimi për të cilën po diskutohet,kjo parcelë që po jepët po kapet me Handikosin dhe me Shkollë dhe ajo qka du me e thanë kur një parcelë kapet në njërën anë me shkollë dhe anën tjetër me Handikosin si dy institucione nuk është dashtë me parapa me hartë zonale si ndërtim tl lartë.

Saniye Kuçi Rexhepaj-Komuna e Suharekës është shumë me fat që i ka hartat zonale në fuqi përshkak që hartat zonale i definojnë blloqet e ndërtimit.Si Komunë apo individë nuk ki të drejtë me ndërto 100% ndërtim dhe për këtë arsye kjo është në kuader të një blloku ndertimor ku zgjidhja ideale është me u bashku krejtë këta pronar qka janë brenda këtij blloku dhe me ndertu një objektë se përfitonë më shumë m². Në ndërtim të përbashkët.

Liridon Fondaj-Përshendetë të pranishmit,te kjo pjesa dhe në heren e kalume e kam ngritë një shqetësim,po mendojë që në media ka qenë dhe prokuroria e ka konfirmu që është një hetim tu u vazhdu për këtë pjesë dhe mos po e bëjmë edhe një shkelje tjetër dhe kërkoj një sqarim nga Drejtori.

Armend Krasniqi-është e vërtetë që është duke u zhvillua një hetim në lidhje me krijimin e asaj rrugës,mirpo Drejtorisë së Pronës i intereson parcela me nr 10 a ka ndonjë kontest ligjor apo ska, a ka ndonjë masë të vendosur nga organet kompetente të cilat vendosin.Përderi sa në regjistrin kadastral kjo parcelë ekziston si parcelë e lir atëher mund të zhvillohen procedura sepse nuk e ka ndalu gjykata për zhvillim të procedurave.

Urim Suka-a ka shqetësim që kjo rruga përderi sa si është nda është në Prokurori,dhe ky vendim me u prishë dhe kjo rrugë mos me ekzistu.Nëse ky vendim prishet rruga nuk ekzistonë bjen ndeshë ti me dhën dhe nëse nuk ka rrug nuk mundet me marrë leje ndertimore.

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 5

4 për,0 kundër 3 abstenime miratohet

Pika 6:Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-51839,të datës 30.08.2024;

Kryesuesi-laboron pikën dhe hapë debatin

Urim Suka- Ne mendojmë që duhet patjetër me u plotësu si Komision,por për deri sa ka dhën dorëheqje ka disa arsye .

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Kryesuesi- i hedhë në votim 2 pika shtesë

4 për,1 kundër,2 abstenime miratohet